



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:063906
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05379808

KPPP.nr.652/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit NHT “Dardania 9000”, nga fshati Dardani në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.B. avokat nga Ferizaji, kundër debitorit EB “Residence” Sh.P.K., me adresë në Ferizaj, rruga “Reçakut” pn, me NRB: 811454511, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.SH. avokat nga Ferizaji, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.179/2023 të datës 29.03.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 12.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET SI I PA AFAT prapësimi i debitorit EB “Residence” Sh.P.K., ndërsa Urdhri P.nr.179/2023 i datës 29.03.2023, i nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Besnik Aliu MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NHT “Dardania 9000” Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.179/2023 të datës 29.03.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave: Faturës nr.019601 e datës 28.02.2022, në shumë prej 1.008 €, Faturës nr.019602 e datës 01.03.2022, në shumë prej 1.417 €, Faturës nr.019603 e 01.03.2022, në shumë prej 594 €, Faturës nr.019604, e datës 02.04.2022,

në shumë prej 26 €, Faturës nr.019608, e datës 30.04.2022, në shumë prej 1.467 €, Faturës nr.019609 e datës 30.04.2022, në shumë prej 720 €, Faturës nr.019610, e datës 01.06.2022, në shumë prej 1.764 €, dhe Faturës nr.019611, e datës 01.06.2022, në shumë prej 622 €, në shumë të përgjithshme prej 7,618.00 €, duke detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga faturat e lartcekura, pas pranimi të këtij urdhri t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 7,618.00 €, me kamatë vjetore 8%, duke filluar nga data 15.07.2016 e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Debitori ka paraqitur prapësim ndaj urdhrin përmbarimor të lartcekur.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.179/2023 të datës 29.03.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Besnik Aliu, e ka pranuar me datë 05.04.2023, e cila vërtetohet nga fletëdërgesa për dorëzim personal e Përmbaruesit Privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është dorëzuar me datën 13.04.2023, e cila vërtetohet nga vula e pranimi të Përmbaruesit Privat që gjendet në shkresat e lëndës.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimi të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qoftë se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme”*.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.179/2023 të datës 29.03.2023, e ka pranuar me datën 05.04.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 06.04.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 12.04.2023, por debitori prapësimin e ka dorëzuar tek Përmbaruesi Privat me datën 13.04.2023, dhe nga kjo rezulton se prapësimi është dorëzuar 1 (një) ditë me vonesë.

Rrjedhimisht, meqenëse është konstatuar pasafatshmëria, gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tjera të parashtruara nga debitori dhe në bazë të nenit 73 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.652/23, me datë 12.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.